



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK

QENDRA E ARTIT DHE KULTURËS KORÇË

### RELACION

#### **PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË FONDIT PËR REALIZIMIN E FESTËS SË BIRRËS NGA BASHKIA TEK QENDRA E ARTIT DHE KULTURËS**

Festa e Birrës event i më i madh turistik veror në Shqipëri i ka dhënë edhe më shumë gjallëri jo vetëm qytetit, por gjithë rajonit duke shtuar vit pas viti numrin e turistëve që e frekuentojnë dhe tashmë prej 17 vjetësh përbën produktin turistik më të suksesshëm në rajon. Kjo traditë vazhdon rrugëtimin e vet me suksese gjithmonë e në rritje.

Festa ka arritur një rritje të madhe nga viti në vit, jo vetëm të numrit të pjesëmarrësve, por edhe parametrave të cilësisë, jo vetëm në mënyrën e shërbimit, por edhe të programit muzikor që shoqëron festën.

Qëllimi i këtij aktiviteti është zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave.

Kërkojmë që fondi prej 15,000,000 lekësh i planifikuar në programin Mbështetje e zhvillimit ekonomik të transferohet dhe të menaxhohet nga Qendra e Artit dhe Kulturës në programin Kultura, sport dhe argëtim, me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET 00 Prog. AC122 Prod. V476AAB 05 Art. 6020000 -15,000,000 lekë (Bashkia)

SHTOHET 00 Prog. AF122 Prod. V822AAD 05 Art. 6020000 +15,000,000 lekë (QAK)

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimin plotësues nr. 1 datë 24.1.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Ligjit nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe

kulturën”, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë”, urdhrin nr. 21 datë 15.1.2024 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2024 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe projekteve”, si dhe rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike të Bashkisë miratuar me VKB, kërkojmë të miratohet transferimi i fondit prej 15,000,000 lekësh nga Bashkia tek Qendra e Artit dhe Kulturës.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS,

BUXHETIT DHE MFK

**Valbona ZIKO**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE  
DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**Anxhela QERAMIXHI (DISHNICA)**

DREJTORE E QENDRËS SË ARTIT DHE KULTURËS

**Zamira BEQIRAJ (KITA)**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Sotiraq FILO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË FONDIT PËR REALIZIMIN E FESTËS SË  
BIRRËS NGA BASHKIA TEK QENDRA E ARTIT DHE KULTURËS**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Qendra e Artit dhe Kulturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimin plotësues nr. 1 datë 24.1.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Ligjin nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë”, urdhrin nr. 21 datë 15.1.2024 “Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2024 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë” sipas programeve dhe projekteve”, rregulloren e financimit të projekteve kulturore, artistike miratuar me VKB, si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

**V E N D O S I**

1. Të miratojë transferimin e fondit prej 15,000,000 lekësh për realizimin e festës së birrës nga Bashkia tek Qendra e Artit dhe Kulturës me këtë strukturë buxhetore:

PAKËSOHET 00 Prog. AC122 Prod. V476AAB 05 Art. 6020000 -15,000,000 lekë (Bashkia)

SHTOHET 00 Prog. AF122 Prod. V822AAD 05 Art. 6020000 +15,000,000 lekë (QAK)

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra e Artit dhe Kulturës si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Eva NAÇI**

**K R Y E T A R**

**ANA VERUSHI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

Zbardhur më datë \_\_\_\_\_